



Hapet thirrja për bursa trajnimi në Universitet Paris Est Créteil Val de Marne, Francë, në kuadër të Programit Erasmus +

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e burses:

Mobiliteti do realizohet gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe do të zgjasë 6 muaj.

Kush mund të aplikojë:

Fusha e studimit:

Mund të aplikojnë studentet e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT në programin:

-Inxhinieri Kompjuterike, Inxhinieri Software dhe Inxhinieri Informatike

Niveli:

Bachelor dhe Master

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikimin:

- Vërtetim dhe listë notash të ciklit aktual të studimit (në gjuhën angleze);
- Cv (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Dëshmi të gjuhës së huaj;
- Letër Motivimi.

Për më shumë informacion mbi dokumentet e aplikimit lutemi kontaktoni me Zyren e Marrëdhënieve me Jashtë në adresën e-mail iro-projects@umt.edu.al.

Afati për aplikim: **26 Tetor, 2022**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën **iro-projects@umt.edu.al** ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.